



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 318/1 prot.

Shkodër, më 12.05.2025

Lënda: Mbi vendimin Nr. 27, Nr.28, datë 28.04.2025 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", të ndryshuar, neni 8, shkronja "a", neni 56 KPAD, të Urdhërit të Kryeministrit nr. 21, datë 05.02.2025 "Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 39, datë 20.02.2025 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 23, pika 7, neni 64, shkronja "c", të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 29, neni 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën me Shqipërisë" i ndryshuar, neni 44. paragrafi i II, të Udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit", pika 109, shkronja "m", pika 120, shkronja "d", të VKQ Shkodër nr. 26, datë 20.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Këshillit të Qarkut Shkodër", të ndryshuar, të VKB Vau Dejës nr. 84, datë 23.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës", të ndryshuar, të Akt Marrëveshjes nr. 1429 prot., datë 26.03.2025 "Për bashkëpunimin ndërvendor në fushën e shërbimeve publike për kryerjen e investimit "Rikonstruksion i rrugës së varrezave Melgushë, Bashkia Vau Dejës" të lidhur mes Bashkisë Vau Dejës dhe Këshillit të Qarkut Shkodër", të shkresës së Këshillit Bashkiak Vau Dejës nr. 2011 prot., datë 02.05.2025 "Shkresë përcjellëse", shqyrtoi VKB Vau Dejës nr. 27, datë 28.04.2025 "Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit mes Bashkisë Vau Dejës me nr. 1429 prot., datë 26.03.2025 dhe Këshillit të Qarkut Shkodër nr. 200 prot., datë 26.03.2025 Për bashkëpunimin ndërvendor në fushën e shërbimeve publike për kryerjen e investimit Rikonstruksion i rrugës së varrezave Melgushë, Bashkia Vau Dejës", me shtesë fondi në buxhet në vlerën 12 000 000 lekë sipas detajimit të bërë të VKQ nr. 26, datë 20.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025" dhe VKB nr. 28, datë 26.06.2024 "Për shtesën e buxhetit të Bashkisë Vau Dejës në VKB Vau Dejës nr. 84, datë 23.12.2024".

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon të procedoni.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS
KESHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 28, datë 28.04.2025

“Për shtesën e buxhetit të Bashkisë Vau Dejës ‘Vkb-në Nr.84 Datë 23.12.2024’ Sipas akt marrëveshjes Nr.1429 Datë 26.03.2025, ndërmjet Këshillit të Qarkut Shkodër dhe Bashkisë Vau Dejës”.

Këshilli Bashkiak Vau Dejës në mbledhjen e tij të datës 28.04.2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika” 1.3, nenet 34-37, 40, 41, 54 shkronja “dh” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar ; kreu III, nenet 10-20, kreu IV, nenet 22-30, kreu VI neni 2, kreu VII, nenet 39-41 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; neni 44 i ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem të NJQV”; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Ligji 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, VKB nr 84 datë 23.12.2024 ‘Miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2025 – 2027, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës” i ndryshuar, dhe Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me nr 860/1 prot datë 06.01.2025, Udhëzimit Plotësues nr 2 datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”, **Sipas Akt Marrëveshjes nr 1429 Prot date 26.03.2025 “Per Bashkepunim ndervendor ne fushen e Sherbimeve Publike per kryerjen e investimit "Rikonstruksion i rruges së Varrezave Melgushë”, Bashkia Vau Dejes, të lidhur mes Këshillit Shkodër përfaqësuar nga Kryetari i Këshillit z.Edmond Ndou dhe Bashkisë Vau Dejës përfaqësuar nga Kryetari z. Kristian Shkreli dhe Vendimit te Qarkut Shkoder nr 6 date 13.03.2025 “Mbi disa Ndryshime ne VKQ nr 26 datë 20.12.2024” Mbi miratimin ne buxhetin e Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025 dhe PBA përfundimtar 2025-2027, dhe relacionit të administratës së bashkisë:, me propozim të kryetarit të bashkisë,Këshilli Bashkiak:**

V E N D O S I:

1.Miratimin e shpërndarjes së shtesës së Buxhetit të Bashkisë Vau Dejës, si më poshtë:

a) Miratimin e shpërndarjes së shtesës së buxhetit të bashkisë, të parashikuar sipas programeve buxhetore, për vitin 2025, të ndara sipas tabelës nr 1, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

3 Ky vendim hyn në fuqi 10 dite mbas shpalljes publike, sipas përcaktimit të nenit 55 të ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar.

Zv/Kryetari Këshillit
Frano PRENGA

Sekretari Këshillit
Ardian ÇELEPIJA



Miraturar me 22 vota

Vota pro 22

Vota kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 02.05.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA EKONOMIKE DHE MENAXHIMIT FINANCIAR
SEKTORI I BUXHETIT DHE FINANCËS

Nr. 468 Prot

Vau Dejes, më 17.09.2025

Lënda: Kërkese për shqyrtim dhe miratim projekt-vendimi.

Z. Ervis Shimaj

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK VAU DEJËS
I nderuar zoti Kryetar,

Bashkelidhur po ju dergojme per shqyrtim dhe miratim projekt-vendimin për "*Shtesën e Buxhetit të Bashkisë Vau Dejës, VKB-në nr 84 datë 23.12.2024*" sipas akt marrëveshjes nr.1429 datë 26.03.2025 ndërmjet Këshillit të Qarkut Shkodër dhe Bashkisë Vau Dejës, për Bashkinë Vau Dejës"

Duke ju uruar pune të mbarë!

KRYETARI
Kristian SHKRELI



Date _____

Nr. i faqeve A4 te projekt vendimit: _____

Nr. i faqeve A4 te relacionit shoqerues: _____

Nr. i fleteve te dokumenteve qe shoqerojne projekt-vendimin: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KRYETAR

PROJEKT-VENDIM

Nr. 04, datë 17.4.2025

PËR

“SHITESËN E BUXHETIT TË BASHKISË VAU DEJËS,
VKB-në NR 84 DATË 23.12.2024”.

**SIPAS AKT MARRËVESHJES NR.1429 DATË 26.03.2025 NDËRMJET KËSHILLIT
TË QARKUT SHKODËR DHE BASHKISË VAU DEJËS.**

Këshilli Bashkiak Vau Dejës në mbledhjen e tij të datës _____.____.2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika” 1.3, nenet 34-37, 40, 41, 54 shkronja “dh” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar ; kreu III, nenet 10-20, kreu IV, nenet 22-30, kreu VI neni 2, kreu VII, nenet 39-41 të ligjit nr. 68/2017 ”Për financat e vetëqeverisjes vendore”; neni 44 i ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem të NJQV”; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Ligji 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", VKB nr 84 datë 23.12.2024 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2025 – 2027, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës”, dhe Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me nr 860/1 prot datë 06.01.2025, Udhëzimin Plotësues nr 2 datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”, *Sipas Akt Marreveshjes nr 1429 date 26.03.2025 “Per Bashkepunim ndervendor ne fushen e Sherbimeve Publike per kryerjen e investimit "Rikonstruksion i rruges së Varrezave Melgushë”, Bashkia Vau Dejes, të lidhur mes Këshilli i Qarkut Shkodër përfaqësuar nga Kryetari i Këshillit z.Edmond Ndou dhe Bashkisë Vau Dejës përfaqësuar nga Kryetari z. Kristian Shkreli dhe Vendimit të Qarkut Shkoder nr 6 date 13.03.2025 “Mbi disa Ndryshime ne VKQ nr 26 datë 20.12.2024” Mbi miratimin ne buxhetin e Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025 dhe PBA përfundimtar 2025-2027, dhe relacionit të administratës së bashkisë:*

V E N D O S I:

1. Të miratojë shpërndarjen e shtesës së Buxhetit të Bashkisë Vau Dejës, si më poshtë:
 - a) Të miratojë shpërndarjen e shtesës së buxhetit të bashkisë, sipas programeve buxhetore, për vitin 2025, të ndara sipas tabelës nr 1, pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Kristian SHKRELI



Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar

A handwritten signature in blue ink, likely belonging to the Director of Economic and Financial Management, written over a horizontal line.

Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Investimeve Publike

A handwritten signature in blue ink, likely belonging to the Director of Territorial Planning and Public Investments, written over a horizontal line.

Drejtoria Juridike e Integrimit Prokurimeve dhe Aseteve

A handwritten signature in blue ink, likely belonging to the Director of Legal Integration of Procurement and Assets, written over a horizontal line. Below the signature is another handwritten mark that appears to be 'Muj 21'.

Institucioni: Bashkia Vau Dejës

Tabela Nr 1: " Shtese e buxhetit te njesise se veteqeverisjes vendore"

Sipas Akt Marrëveshjes Nr.1429 datë 26.03.2025 "Per Bashkepunim ndervendor ne fushen e Sherbimeve Publike per kryerjen e investimit "Rikonstrukcion i rruges së Varrezave Melgushë", Bashkia Vau Dejës , dhe Vendimit te Qarkut Shkoder nr 6 date 13.03.2025.

SHTOHET

Në Lekë

Entit.i Qev.	Min.e Linjes	Kod Instit.	Emër Institucioni	Kap.	Programi	Llog. Ekon.	Kodi i Degës së Thesarit	Kodi i produktit	Debiti 2025	Emërtimi i Projektit
157	00	2157001	Bashkia Vau-Dejes	05	04520	2310000	3333	1570859	12,000,000.00	"Rikonstrukcion i rruges së Varrezave Melgushë"
SHUMA TOTALE										12,000,000.00

Nëpunësi Zbatues
Elsa Tanushi



Nëpunësi Autorizues
Kristian Shkrel



RELACION

PËR

PROJEKT VENDIMIN

PËR

“SHITESËN E BUXHETIT TË BASHKISË VAU DEJËS,

VKB-në NR 84 DATË 23.12.2024”.

SIPAS AKT MARRËVESHJES NR.1429 DATË 26.03.2025 NDËRMJET KËSHILLIT TË QARKUT SHKODËR DHE BASHKISË VAU DEJËS.

QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projekt vendim ka për qëllim shtesën e buxhetit të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr 84 datë 23.12.2024 ‘Miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2025 – 2027, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës’, dhe Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me nr 860/1 prot datë 06.01.2025.

Me zbatimin e buxhetit te vitit 2025 ka lindur nevoja për shtesën e buxhetit të bashkisë për arsye të *Akt Marreveshjes nr 1429 Prot date 26.03.2025 “Për Bashkepunim ndervendor ne fushen e Sherbimeve Publike per kryerjen e investimit "Rikonstruksion i rruges së Varrezave Melgushë”, Bashkia Vau Dejes, të lidhur mes Këshillit Shkodër përfaqësuar nga Kryetari i Këshillit z.Edmond Ndou dhe Bashkisë Vau Dejës përfaqësuar nga Kryetari z. Kristian Shkreli, e cila është lidhur për mënyrën e lëvrimin të fondeve në të cilën sipas nenti 3 të akt marrëveshjes “Qarku në një kohë sa më të parë me fondet e planifikuara të vitit 2025 dhe përkatësisht shuma prej 12,000,000 (dymbëdhjetë milion) lekë e planifikuar nga Transferta e Pakushtëzuar e vitit 2025 dhe nga fondet e trashëguara nga viti 2024, bën menjëherë transferimin e kësaj shume tek Bashkia, për kryerjen e investimit me objekt :”Rikonstruksion i rrugës së Varrezave Melgushë, Bashkia Vau Dejës”. Qarku ka kryer procedurën e transferimit të fondeve sipas pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Qarkut Shkodër Nr.6 datë 13.03.2025.*

Ky Projekt Vendim është bazuar dhe në Vendimin e Qarkut Shkodër nr 6 date 13.03.2025 “Mbi disa Ndryshime ne VKQ nr 26 datë 20.12.2024”Mbi miratimin ne buxhetin e Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025 dhe PBA përfundimtar 2025-2027, sipas nenit 2 “Të miratohet transferimi i fondit të planifikuar në buxhetin 2025 për investimin “Rikonstruksion i rrugës së varrezave Melgushë, Bashkia Vau Dejës në shumën prej 12,000,000 lekësh , nga Këshilli i Qarkut në Bashkinë Vau Dejës. Ky fond do të përdoret për këtë investim por nga Bashkia Vau Dejës.

Prandaj buxheti i bashkisë miratuar sipas VKB nr 84 datë 23.12.2024 “Miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2025 – 2027, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës”, dhe Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me nr 860/1 prot datë 06.01.2025 shtohet me vlerën prej **12,000,000** (dymbëdhjetë milion) lekësh,

dhe zerin e investimit "Rikonstruksion i rrugës së Varrezave Melgushë" Bashkia Vau Dejës, ne programin 04520 dhe kod produkti 1570859.

VLERËSIMI I PROJEKTVENDIMIT NË RAPORT ME PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM 2025-2027, DHE ME BUXHETIN E VITIT 2025.

Projekt Vendimi është parashikuar duke u bazuar në politikat dhe strategjinë e programit të PBA-së 2025-2027 dhe me Buxhetin e vitit 2025

I. ARGUMENTIMI I PROJEKTVENDIMIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Përparësia e këtij projektvendimi është përmirësimi i shërbimit të ofruar nëpërmjet planifikimit dhe buxhetimit eficient dhe i mirë-analizuar i shpenzimeve publike me synim rritjen e efektivitetit dhe përdorimit ekonomik të fondeve publike

- Menaxhimi efektiv i të ardhurave vendore si një mënyrë e rëndësishme për të rritur investimet dhe në interesin publik;
- Rritje e cilësisë së infrastrukturës në territorin e bashkisë;
- Konsolidimi i shërbimeve publike;
- Nxjitje e zhvillimit ekonomik për bizneset;
- Ndërtimi i infrastrukturës moderne: Infrastruktura rrugore

Këto ndryshime do të bëjnë të mundur përmirësimin e fushave kryesore aktuale, duke rregulluar balancat, rritur shërbimin dhe duke rritur funksionin që ka bashkia për sektorë të ndryshëm në territorin e saj

III. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektvendim është në harmoni të plotë me:

1. Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar,
2. Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore, i ndryshuar
3. Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar,
4. Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" të ndryshuar;
5. Ligji 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025",
6. Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"
7. Vendim i Këshillit Bashkiak nr 84 prot me datë 23.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës, të miratuar me shprehje ligjshmërie nga Prefektura Shkodër me nr 860/1 prot dhe datë 06.01.2025.
8. Udhëzim plotësues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr 2 datë 24.01.2025 "Për zbatimin e buxhetit 2025".

9. Vendimin e Qarkut Shkodër nr 6 date 13.03.2025 "Mbi disa Ndryshime ne VKQ nr 26 datë 20.12.2024 "Mbi miratimin ne buxhetin e Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025 dhe PBA përfundimtar 2025-2027.
10. Akt Marrëveshjes nr 1429 date 26.03.2025 "Per Bashkepunim ndervendor ne fushen e Sherbimeve Publike per kryerjen e investimit "Rikonstruksion i rruges së Varrezave Melgushë", Bashkia Vau Dejes, të lidhur mes Këshillit Shkodër përfaqësuar nga Kryetari i Këshillit z.Edmond Ndou dhe Bashkisë Vau Dejës përfaqësuar nga Kryetari z. Kristian Shkreli

IV. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Mbi domosdoshmërinë e investimeve të shtuara

Sektori i Investimeve Publike mendon të shtojë realizimin e objekteve për vitin 2025

1. "Rikonstruksion i rrugës së Varrezave Melgushë" Bashkia Vau Dejës

Përgjegjës i Investimeve dhe Projekteve Publike

Indrit Kurtbegu

Drejtorja Juridike e Integrimit Prokurimeve dhe Aseteve

Marinela Deda

Përgjegjës i Buxhetit dhe Financës

Armena Zagani

Drejtorja Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar

Drejtor

Elsa Tanushi

KRYETAR

Kristian Shkreli

